



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 128, qershor 2014

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

PREZANTIM DINJITOK I KULTURËS SHQIPTARE NGA SHOQATA "ILIRIA"

- Në festivalin e 19-të, ritmet dhe vallet e Botes në Giavera del Montella-TV -



"Kënga dhe Këngëtarët Shkodranë"

Në kuadrin e aktiviteteve me rastin e 10 vjetorit të hapjes së Konsullatës së Nderit të Austrisë në Shkodër, me datë 23 Qershor 2014, ora 10.00 në Sallën e Lekioneve të Rektoratit në Universitetin e Shkodrës u promovua me sukses libri "Kënga dhe Këngëtarët..."

4

AKULLORJA FEST

Një festival për fëmijë që solli freskinë dhe shijen e akullores

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

ME 15 QERSHOR 1389 U ZHVILLUA BETAJA E FUSHE-KOSOVËS!

Kujtesa historike për gjithë shqiptarët

Dihet historikisht se, me 15 qershor 1389, në Fushe-Kosovë u zhvillua beteja e parë e koalicionit Kristian të Ballkanit, e cila asht quajti "beteja e Kombeve". Dihet gjithashtu se, në kte beteje të përgjakshme kunder hordhive osmane të Sulltan Mehmetit, morën pjesë dhe katër prijës të Arbërisë: Gjon Kastrioti, Gjergj Balsha, Araniti dhe Muzaka.

8

MARTIN GJONI "nuk i trembet varrit"

5

U mbushën njëzet vjet që është ndarë një jeta Martin Gjon Gila nga fshati Lotaj i Dukagjinit. Në këtë përvjetor po sjellim disa momente nga kujtime të bashkëkohësve dhe pak nga veprimtaria e tij e gjerë për një kohë mjaft të gjatë, ose më mirë me thënë për gjithë jetën e tij, pasi gjithë jeta e tij ka qenë në shërbim të vendit, të komunitetit, të Dukagjinit, me qëllim kujtimin e tij, por edhe për ti treguar brezit të ri dhe atyre që vinë se Martin Gjon është nga ata veprimtarë të palodhur që punuan me përkushtim për të mirën e popullit dhe vendit, të cilët duhet kujtuar gjithnjë.

3

Mundësoi Botimin:
NDUE FTONI



YLLI I BEXHISTENIT

- Një dritë e pashuar në pendën e një shkrimtari -

Në kuadrin e veprimtarive të njëpasnjëshme që po organizon klubi i shkrimtarëve të Shkodrës, në lokalin “Bexhisteni” në hyrje të këmbësorës të Urës së Bunës, u organizua edhe paraqitja e novelës “Ylli i Bexhistenit” e shkrimtarit Fadil Kraja, “Mjeshtër i Madh”. Mes kolegësh të shumtë, miqve e dashamirëve të librit e të autorit, u fol nga këndvështrime të ndryshme për vlerat e kësaj vepre, e cila është de-

t’ia bëjmë të gjithëve të njohur, sepse duke njohur këto vlera, nuk bëjme gjë tjetër veçse shtojmë diçka në mozaikun kulturor që Shkodra e ka aq të hershëm e madhështor.

Skender Temali, kryetar i klubit të shkrimtarëve të Shkodrës tha se personazhi kryesor i novelës, Ylli, ka hedhur themelet e një bote të re dhe ka krijuar një imazh të asaj që të tjerët momentalisht nuk e shihnin.

nuk ka botuar vëllim më vete, pasi lexuesi shqiptar, si brenda dhe jashtë kufijve ka parë e ndjerë polenin e veprave të tij poetike, dramaturgjike, në tregime e romane. Risinë në novelë atij ia jep siguria në të shkruar, dialogu ekspresiv edhe i karakterit dramatik, herë me mesazhe të drejtpërdrejta e herë me nëntekste, me realitet që herë akuzojnë e herë pohojnë, duke u thënë të gjithëve se kush përpiqet e lufton për të renë, e meriton

i Shkodrës, i vetmi dhe unik, jo vetëm në Shqipëri, por në tërë rajonin dhe që këmbëngulja e Astrit Meshnunit, bëri që ai t’i rikthehej Shkodrës në një formë më moderne e bashkëkohore.


Rreth vlerave të novelës folën disa shkrimtarë, si Dashamir Cacaj, njëkohësisht edhe sekretar i klubit të shkrimtarëve të Shkodrës, Xhahid Bushati, shkrimtar i mirënjohur për fëmijë dhe studiues arti, Zija Vukaj, kritik letrar dhe përkthyes, Lekë Imeraj, shkrimtar e përkthyes dhe Kadri Ujkaj, kritik, ndërsa aktori Ramiz Rama interpretoi një fragment nga novela.

Në këtë promovim të novelës së Fadil Krajës, “Ylli

shkrimtarëve Shkodër.

Në fund për të pranishmit u shtrua edhe një koktejl në shenjë falenderimi dhe mirënjohjeje, që shërbeu për më tepër dhe si një tavolinë diskutimi krijues, sidomos në shkëmbimin e eksperiencave midis brezave krijues.

Në mbyllje të aktivitetit e mori fjalën për të falenderuar shkrimtarin e madh Fadil Kraja, Pranvera Meshnuni, bashkëshortja e personazhit të novelës, për respektin dhe përjetësimin që i ka bërë figurës së bashkëshortit të saj, si dhe të pranishmit e shumë që asistuan në këtë takim promovues, premtori dhe garantoi se idetë, dëshirat dhe projektet e shumta që As-



dikim për një jetë njerëzore, e cila u shua në një moshë të re, Astrit Meshnuni.

Okelio e kësaj novele janë dy vargje të një kënge shkodrane: “Ai që t’mira i bën Shkodrës, Shkodra emrin s’ja harron”. Pikërisht kjo është detyra e të gjithë artistëve, të nxjerrin në pah ata që i bënë të mira vendlindjes së tyre. Nëpër kohëra janë të shumtë, disa janë harruar padrejtësisht, por detyra jonë është që këtë harresë ta zhdukim, t’ia bëjmë Shkodrës të njohur,

Ai ndër të tjera u shpreh: “Kam një gjysmë shekulli që e njoh Fadil Krajën, që ia di krijimtarinë dhe karakterin deri në gen, që e di se pena e tij nuk pushon kurrë. Edhe sot mund të jetë ndër krijuesit më jetëgjatë shqiptarë, ndaj dhe nuk gaboja kur them se ai është një pus që nuk shteron kurrë”

Duke iu referuar botimit më të fundit të mikut dhe kolegut të tij, Temali më poshtë vazhdoi: “Tani Kraja na jep një novelë. Është zhanri ku ai

atë. Mozaiku subjektor të bën që novelën të mos e lëshosh nga dora pa i shkruar deri në fund”.

Më konkretisht, personazhi i novelës, ish-sportist, kampion i mundjes së Vllaznisë, më pas biznesmeni i suksesshëm i ndërtimeve, ku krahas të tjerave, njihet edhe si ideuesi dhe realizuesi i ndërtimit të kompleksit tregtar, “Bexhisteni” në hyrje të qytetit të Shkodrës, aty ku qindra vite më parë, ekzistonte Bexhisteni i famshëm

Bexhistenit”, vajza e atij që i kushtohet novela, Amina Meshnuni, edhe pse atë ditë kishte ditëlindjen e mbushte 14-vjeç, pra ende e re në moshë mes shumë krijuesve me emër, ngriti peshë emocionet e të pranishmëve me një krijim të sapo krijuar, ndërkohë që promovoi e dhuroi edhe dy librat e botuar prej saj me tituj: “Jam bijë e një legjende, që shkroi historinë” dhe “Hardhuci pa bisht”.

Me këtë rast u bë dhe pranimi i saj si anëtare e klubit të

triti kishte për të bukurën në qytetin e tyre të lindjes, do të vijonte t’i zbatonte ajo dhe familja “Meshnuni” me tërë përkushtimin e saj.

Në fund, një tjetër yll i jetës artistike në Shkodër e më gjërë, edhe në Italinë elitare në këngë, Elhaida Dani me grupin e saj orkestral, me interpretimet nga muzika bashkëkohëse shqiptare dhe e huaj, i dhanë freski këtij aktiviteti.

Pergatite **Ramazan ÇEKA**

AKULLORJA FEST

Një festival për fëmijë që solli freskinë dhe shijen e akullores

Me 1 Qershor, Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve në skenën e Teatrit “Migjeni” në Shkodër me iniciativën e Shoqatës Kulturore Artistike “Mark Kaftalli”, në bashkëpunim me Shoqatën “World Vision”, nën kujdesin dhe drejtimin e z. Anton Kaftalli, u prezantua për herë të parë një festival lokal për fëmijë i titulluar “Akullorja Fest”. Ky eveniment padyshim është edhe edicioni i parë i këtij formati që debutoi me shumë sukses para publikut shkodran.

Tempulli i artit skenik, Teatri “Migjeni” i priti me shumë dashamirësi vogëlushët që me performancën e tyre i dhuruan qytetit në këtë stinë verore një “akullore” të madhe dhe të shijshme.

Për të prezantuar para publikut këtë “akullore” të madhe, dhe mua më pëlqen ta perifraroj atë, sepse edhe ky festival ishte titulluar “Akullorja Fest”. Morën pjesë rreth 60 “pasticierë” të vegjël të këngës që kishin sjellë dikush qumështin, dikush çokolatën, dikush fruta pylli, dikush vanilje dhe në përfundim “akullorja” u pëlqye nga të gjithë si një arritje në kultivimin dhe krijimtarinë e këngës për fëmijë që aq shumë na mungon.

Natyrisht artistët e vegjël e realizuan këtë vepër të tyre nën kujdesin e mjeshtreve të muzikës dhe poetëve të talentuar që kishin sjellë në këtë festival krijimet e tyre më të mira.

Shfaqja ishte vënë në skenë me shumë profesionalizëm nga regjisorja Rita Gjeka.

Mes protagonistëve të këtij festivali kishte plot fëmijë nga familje që jetojnë në vështirësi ekonomike nga i gjithë Qarku i Shkodrës e sidomos nga Rrethinat. Përfshirja e shtresave shoqërore në nevojë në sa më shumë veprimtari kulturore ishte dhe mesazhi që synoi të japë ky festival. Pikërisht për këtë arsye ishte zgjedhur dhe 1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve për të sensibilizuar publikun shkodran. Po ashtu, qëllimi tjetër jo pak i rëndësishëm i këtij aktiviteti ishte edhe zbulimi i talenteve të reja si dhe nxitja e kompozitorëve dhe letrarëve vendas për të kontribuar në këtë drejtim.

Festivali filloi me refrenin e këngës “Akullorja”, me tekst të Çesk Ndreçës dhe muzikë të Mark Kaftallit, si një inspirim dhe frymëzim që mblodhi pjesëmarrësit në festivalin e këngës për fëmijë “Akullorja Fest”.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti u kujtuan me respekt artistët kompozitorë dhe poetë shkodranë: Leonard Deda, Zydi Barbullushi, Zef Leka, Gjon Kapeda-

ni, Gjoshio Vasia, Adil Ujkashi, Tonin Daia, Adil Zeka, Lajde Banushi, Fadil Kraja, Xhahit Bushati, Paulin Shtjefni e të tjerë.

Festivali vazhdoi rrjedhën e tij me in-

përbërëj nga: Françeska Kovaçi, Djana Alibali, Lukë Mllugjeni, Lekë Jakova dhe Vera Çuni, pa lënë pas edhe punën e Viola Bajraktarit, e cila punoi me shumë përkushtim dhe pasion me orkestrën e harqeve me fëmijët e vegjël instrumentistë, si dhe përkujdesjen e ideatorit të veshjeve të fëmijëve dhe i skenografisë Elvis Buraniqi. Edhe inspektori i skenës Sabah Baxha me gjithë prapavijën e Teatrit, punuan me shumë kujdes për të krijuar kushte komode.

E veçantë në këtë festival ishte edhe rikthimi i formacionit orkestral në skenë, që këtë radhë në përbërjen e tij kishte vetëm instrumentistë të vegjël. Gjithashtu formacioni vokal “Kori” ishte i konceptuar në regjinë skenike si dy komplekse të mëdha vokale të vendosur në dy anët e skenës si një kurorë e bukur me lule plot aromë, i përbërë nga 50 vajza lulebore, të cilat sillnin freskinë e tyre dhe aromën e Shkodrës.

Sigurisht që pjesë e kontributit dhe suksesit të këtij eventi ishte edhe mbështetja e Drejtorit të Teatrit “Migjeni” z. Edmond Angoni, së bashku me ideatorin dhe drejtorin artistik Anton Kaftalli.

Për këtë aktivitet të bukur fëmënor, organizatorët falënderuan për kontributin e tyre sponsorët: Mobileri “Europa”, Bar Restorant “Er-vini”, Shkolla “Përparimi” me presidente znj. Lindita Reçi, Vjollca Jahja dhe Herri Muça.

Justina Ndreca, është bija e të ndjerit Çesk Ndreca, autorit të tekstit “Akullorja”. Ajo jeton në SHBA së bashku me familjen e saj.

Idenë e risjellës së Festivalit Lokal të këngës për fëmijë me logon “Akullorja Fest”, ajo jo vetëm e priti me shumë en-

tuziazëm, por ndihmoi konkretisht duke mbështetur financiarisht, së bashku me znj. Ketil Bazhdari, orkestracionet e këngëve.

Një punë shumë profesionale kishin bërë edhe orkestruesit e këngëve Ilir Zoga, njëkohësisht edhe udhëheqës artistik i “Akullorja Fest”, Gazmend Kraja, Andi Unaza, Roland Guli, Luan Dagistani dhe Islam Axhemi.

Për të përshëndetur këtë festival kishin ardhur nga Ulqini edhe grupi i vajzave “Konsonanca” dhe vogëlushja këngëtare Dorina Çoba me këngën “Mësueses time”, të cilat u pritën me mjaft entuziazëm nga publiku në sallë.

Juria përbëhej nga 5 artistë profesionistë të mirënjohur të Shkodrës, me kryetare Miranda Mazi, anëtarë Violeta Bajraktari, Oleg Gjergaj, Orjeta Kelaj dhe Sidi Kanani.

Festivali u prezantua nga një dyshe aktorësh të Teatrit “Migjeni” të Shkodrës, Sara Smaja dhe Jozef Shiroka.

Dhe natyrisht, pas përfundimit të interpretimit të këngëve, fjalën e kishte juria. Për të shpallur fituesit u ngjiti në skenë kryetarja e jurisë Miranda Mazi, ku si fitues i çmimit të tretë u shpall kënga “Për ty babi” me tekst të Bujar Ferhatit, muzika Lekë Jakova, kënduar nga Kejsi Rustja dhe Kori. Çmimin e dytë e fitoi kënga “Ku të lozim” me tekst të Ramazan Çekës, muzika Andi Unaza, kënduar nga Ingrid Havalja dhe Lorenca Preçi. Çmimin e parë e fitoi kënga “**Kafshët e pyllit kërcëjnë rrok**” me tekst të Denisa Domnorit, muzika Enrik Çefa e kënduar nga Kori.

Gjithashtu në këtë eveniment u dhanë edhe dy diploma për muzikantët e karrierës nga Zv/ Ministri i Kulturës, Zef Çuni, dedikuar Mark Kaftallit dhe Agim Velës.

Sipas traditës, përmes entuziazmit dhe duartrokitjeve në sallë u këndua edhe një herë kënga fituese e cila krijoi një atmosferë shumë festive.

Pergatite nga **Ramazan ÇEKA**



terpretimin e këngëve shumë të bukura të cilat ishin krijuar dhe punuar me kujdes si nga teksti, kompozimi, orkestracioni dhe nga interpretimi me freski i zërit brilant nga fëmijët këngëtarë.

Ekipi realizues që punoi me vokalin



“Kënga dhe Këngëtarët Shkodranë”

Në kuadrin e aktiviteteve me rastin e 10 vjetorit të hapjes së Konsullatës së Nderit të Austrisë në Shkodër, me datë 23 Qershor 2014, ora 10.00 në Sallën e Leksioneve të Rektoratit në Universitetin e Shkodrës u promovua me sukses libri “Kënga dhe Këngëtarët Shkodranë” me autor studiuesin e pasionuar të muzikës z. Ferid N. Bala. Këtë aktivitet e nderuan me pjesëmarrjen e tij përfaqësuar nga Shteti shqiptar dhe Austriak si edhe Arqipeshkvi i Metropolit Shkodër –Pult dhe kryetarë i konferencës Ipeshkvore Imzot Angelo Masaffra.

Promovimi i këtij libri, i cili vjen në formën e një monografie, u monitorua nga kompozitori, Gjon Shllaku, ish nxënës i profesor Ferid Bales, sot, kryetar i shoqatës artistike Kombëtare “Prenkë Jakova”, i cili ishte edhe i pari që mori fjalën në këtë promovim. Për jetën dhe karrierën e pasur artistike të profesor Feridit kanë folur me radhë, kompozitori dhe studiuesi i muzikës Zhani Ciko, Frano Kulli administrator i Entit Botues “Gjergj Fishta” që ka nxjerrë në treg librin në fjalë, Konsulli i Nderit i Austrisë në Shkodër, Gjergj Leqejza, studiues gjakovar, Behar Arllati, Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, z. Thomas Schnöll, Zv.ministria e Arsimit dhe Sporteve, Nora Malaj, Zv. ministri i Kulturës, Zef Çuni, e të tjerë. Referuesit në fjalë e cilësuan punën dhe veprën e muzikantit dhe studiuesit Bala, si një vlerë të çmuar, në lëmin e këngës popullore shkodrane, jo vetëm për Shkodrën, por edhe gjerë në shkallë kombëtare, përfshirë edhe ato të trevave shqiptare jashtë vendit.

Studiuesi i muzikës Shqiptare z. Zhani Ciko, bëri një paraqitje të zanafillës së muzikës Shqiptare, i cili këtë zanafillë e kishte gjetur tek kënga maje krahu, e cila ka ardhur duke u gërshetuar nga shekullin në shekull duke përcjell vlerat të papërsëritura. Ajo vjen edhe në këtë libër e grumbulluar dhe studiuar mjaftë nëpërmjet autoreve të saj, të cilët e ndër-tuan Këngën popullore Shkodranë dhe interpretimin e saj, një herë e mirë për tu pasur lakmi.

Për auditorin ishte emocionues dhe çasti i parë kur u hollën hapat e para të botimit të kësaj monografie të cilën në fjalën e tij e zbuloi, Konsulli i Nderit i Austrisë në Shkodër z. Gjergj Leqejza. E theksoi ishte emocionues, sepse dashuri për artin dhe të bukurën i takon njerëzit, të cilët duke bashkëpunuar na dhurojnë vepra të tilla si kjo e sotmja. Duke folur për koleksionin e disqeve dhe të gramafonit, filloi puna, që studimi i profesor Feridit te kete i filluar që në vitet 1970, ti hapej drita jeshile e botimit. Dhe kështu pas shumë orësh punë ndërtuese, vepra sot vjen si thesar për ne dhe brezat që vinë. Kjo vepër i shtohet jo vetëm bibliotekës Shqiptare, por edhe statistikave të qeveris Austrake, e cila me shekuj ka ndikuar dhe ndihmuar Shqipërinë në fusha të ndryshme të jetës, ku një vend të veçantë zë arti, kultura dhe arsimit.

Z. Frano Kulli administrator i Entit Botues “Gjergj Fishta” tha se kjo vepër, monografi enciklopedike e këngës dhe

këngëtarëve shkodranë, rrok tre shekuj krijimtari dhe interpretim muzikor, evidenton këngën dhe këngëtarët shkodranë. Për ne si ente botues e rritë kolanën e botimeve të veprave të shquar, më të shquarve Shqiptar dhe për këtë ne, ju falënderojmë që na zgjodhët.

Ferid N. Bala, i cili falënderoi të gjithë të pranishmit për fjalët e mira dhe për respektin dhe ndihmën e treguar. Ai theksoi punën shumë vjeçare për të ardhur deri këtu dhe them se për mungesë informacionesh kanë mbetur edhe personazhe të tjera pa u vendos në faqet e

vlerave vokale edhe vlerat interpretative të tyre, të ruajtjes, por edhe të përpunimit me taban lokal dhe kombëtar gjatë interpretimit.”

Emocionues ishin edhe përshëndetjet që bënë, këngëtarja lirike Sabahet Vishnja dhe Myfarete Laze, të cilat në zbuluan



Studiues gjakovar z. Behar Arllati, tha se risolla në kujtesën tonë këtë thesar të trashëgimisë kulturore shqiptare, sidomos për gjeneratat që vijnë, është shërbimi më i mrekullueshëm që i bëhet identitetit tonë kombëtar.

Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, z. Thomas Schnöll theksoi së, puna jonë si shtet në vendin tuaj behët shumë e lehtë kur ke bashkëpunëtorë si z. Gjergj Liqejza, Kunsull Nderi në Shkodër, i cili ti sjell të gjitha gati dhe këmbëngulë që puna të realizohet shpejt dhe mirë. Është kënaqësi dhe garanci për ne, që të trashëgojmë traditën e mirë të bashkëpunimit mes dy popujve.

Mes emocioneve të veçanta autori

saj. Kjo monografi është e ndare në tri kategori këngëtarësh, të cilët e krijuan dhe e jetësuan këngën popullore të paarritshme. Për mua është kënaqësi që mu dha rasti të punoja me shumë njerëz dhe për shumë njerëz ku tek secili e gjeta dashurin për artin dhe Shkodrën.

Zv. ministria e Arsimit dhe Sporteve z. Nora Malaj pas falënderimit për punën e bërë theksoi se ku ka më bukur që çdo gjë të filloj nga Shkodra.

Zv. ministri i Kulturës z. Zef Çuni e cilësoi këtë Monografi si gurë themeli i këngës shkodrane.

Nga parathënia e monografisë do të citonim: “Libri ka si qëllim kryesor që të evidentojë vlerat artistike në interpretim, prandaj unë kam marrë në analizë veç

dhuntinë e profesorit për ta zbuluar talentin dhe për tar rite edhe pse sfidat e asaj kohe ishin të mëdha. Të promovosh një monografi, e cila i kushtohet këngës dhe këngëtarëve do mbetej diçka mangët po mos ti dëgjoje tingujt e kësaj këngë. Këtë emocion na e dhuroi, rezervoi për profesorin saj, Ferid Bala dhe të pranishmit, këngëtarja lirike Sabahet Vishnja, me interpretimin e këngës «Për mu paska kenë kismet».

Promovimi u mbyll i shoqëruar nga shkrepjet e aparateve fotografike, të cilat fiksuat një ditë të paharrueshme për autorin në fjalë por edhe për muzikën Shqiptare.

Përgatiti Roza Pjetri

MARTIN GJONI “nuk i trembet varrit”

U mbushën njëzet vjet që është ndarë një jeta Martin Gjon Gila nga fshati Lotaj i Dukagjinit. Në këtë përvjetor po sjellim disa momente nga kujtime të bashkëkohësve dhe pak nga veprimtaria e tij e gjerë për një kohë mjaftë të gjatë, ose më mirë me thënë për gjithë jetën e tij, pasi gjithë jeta e tij ka qenë në shërbim të vendit, të komunitetit, të Dukagjinit, me qëllim kujtimin e tij, por edhe për ti treguar brezit të ri dhe atyre që vinë se Martin Gjoni është nga ata veprimtarë të palodhur që punuan me përkushtim për të mirën e popullit dhe vendit, të cilët duhet kujtuar gjithnjë.

Që nga lindja e deri në vitin 1942 qëndroi në fshatin e tij të lindjes dhe zonën e Shalës në Dukagjin. Është i biri i Gjon Ndocit dhe nip i Bejto Ndocit, të cilët qenë, që në rininë e tyre, përkrahës të përpjekjeve për liri, pavarësi dhe përparim. Baba dhe axha i Martinit morën pjesë me armë në dorë në luftën e Qafës së Agrit, ku u thye ushtria osmane në vitin 1910. Po kështu edhe në përpjekjen me ushtrinë Malazeze në vitin 1915. Shtëpia e tyre u dogj dy herë, edhe nga osmanët edhe nga malazezët. Shtëpia e Gjon Ndocit ishte një nga bazat më të rëndësishme për Bajram Currin. Bejto Ndoci ishte gjithnjë bashkëpunëtor dhe përkrah Bajram Currit në gjithë lëvizjen e tij në të mirë të Atdheut

Sa qe pranë familjes, Martini, qe shumë i përkushtuar asaj, në të gjitha punët që kërkonte familja. Ishte shumë i interesuar për të ndihmuar ata që ishin në nivel më të ultë ekonomik, ata që kishin nevoja shëndetësore, e të tjera. Martin Gjoni ishte mjaft aktiv në të gjitha punët dhe problemet që kishte nevojë fshati Lotaj, ishte i papërtueshëm, energjik dhe shumë bashkëpunues në biseda e punë, ndërhynte dhe ndihmonte, me të gjitha mundësitë, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fshat e më gjerë.

Në fillim të verës e vitit 1942, siç tregonte Lulash Sokoli, po rrugëtonin bashkë me Martinin për në pazarin e Shkodrës me disa bagëti për ti shitur, së bashku dhe me disa banorë të tjerë nga Lotajt. Pasi kalojnë Malin e Shoshit dhe zbresin në Prekal, te Ujëti e Zhylës bëjnë një pushim që të sh’ lodheshin pak, të hanin bukë vetë, por dhe bagëtitë të hanin diçka. Bashkë me Martinin e Lulash Sokolin ishte edhe Pllumb Ndoka, që Martini e kishte mik. Sapo kishin

filluar të pushonin vinë dhe takohen me ta tre vete që nuk i njihnim. Ata ju drejtuan Lulashit, pasi ishte më i vjetri, për të folur me të. Pas pak marrin vesh si ishin Sadik Bekteshi, Qazim Kapisyzi dhe Xhevdet Gavoçi. Ata kishin marrë rrugën për në



Dukagjin dhe i kërkojnë Lulashit që ti përcillnin deri në Shosh, në Pepsuj, sepse, siç thanë ata, kishin një punë të rëndësishme. Ata kërkuar që ti shoqëronte dikush që të binin sa më parë në Pepsuj për tu takuar me Kolë Prelën, Gjellosh Lushin, Bal Markun dhe pastaj do të shkonin në Brashtë në shtëpinë e Gjon Marashit, në Toplanë te Ndue Micani, e te tjerë. Ata i kishin thënë se do tu jepnin nga një pushkë atyre që do ti përcillnin. Martini kishte bagëtitë për ti shitur, ndërsa Pllumbi nuk kishte bagëti, por po udhëtonte me ne – tregon Lulash Sokoli. Unë, pasi Martini shfaqti dëshirën për të shkuar me ata dhe na kërkoj që ti merrnim bagëtitë për ti shitur, marr bagëtitë, thotë Lulashi. Ne i morëm bagëtinë për ti shitur dhe për të blerë ato që kishte në plan për të blerë në Shkodër për familjen e tij. Martini mori me vete edhe Pllumbin dhe u nisën më ata për në Shosh duke kaluar nëpër mes Qafës së Çisë, Lugut të Qershisë, kaluan përronin e Stupes, dolën në Kodër të Kujit dhe ranë në Pepsuj. Me

sa duket Martini kishte rënë në kontakte me lëvizjen për çlirim edhe më parë, por me këta persona nuk ishte takuar asnjëherë më parë e nuk i njihje, dhe kur e mori vesh se kush ishin menjëherë u kthye që ti shoqëronte për në Shosh.

Me formimin e Çetës së Dukagjinit në Pepsuj në fillim të vjeshtës së vitit 1943, Martin Gjoni, caktohet zëvendës komisar i saj. Çeta kishte për komandant Gjon Marashin, zëvendës komandant Ndokë Gjellosh Xhuxhi, komisar Kolë Prelën.

Nga kontaktet e para me lëvizjen nga fillimi i vitit 1942 dhe deri në formimin e Çetës së Dukagjinit, Martin Gjoni nuk është ndarë asnjëherë nga veprimtaria e tij për ngritjen e opinionit për luftën për çlirimin e vendit, duke bashkëpunuar edhe më shumë të tjerë që përkrahnin lëvizjen nacionalçlirimtare, si Market Pjetra, Martin Kola, Mushak Dedën, Lulash Sokolin, Ndokë dhe Vatë Gjelloshin, Prelë Binakun, Marash Palokën, Ndokë Nikën e shumë të tjerë në të gjithë Shalën. Këta prinin telat e telefonit, u zinin prita patrullave italiane, sulmonin postën në Kodër të Shëngjergjit, dogjën flamurin fashist te Kisha e Shalës, në Breglumi, e të tjera. Martin Gjoni u përpoq shumë për të bërë të mundur gjetjen e Mirash Pal Vuksanit, që ishte

internuar në kampet e përqendrimit të ushtrisë hitleriane si luftëtar i vendosur dhe aktiv kundër pushtimit italo-gjerman. Gjetja e vendndodhjes së fundit të Mirash Pal Vuksanit, dhe vdekja tragjike e tij u bë e mundur pas vdekjes së Martinit. Mirash Pal Vuksani është shpallur dëshmor i atdheut deh familja e tij, ka marr statusin “Familje Dëshmori”.

Zef Shytani, sot 86 vjeç, tregon për largimin që Martin Gjoni bëri nga fshati dhe nuk u shkëput më nga lufta deri me çlirimin e vendit. “Ishim në bagëti në Rrah të Ndre Buxhës me Martinin e Kolë Ndue Sokolin, që po i vesh-tonim, - tregon Zefi. “Shpesh na i lente bagëtitë dhe largohej për 2-3 ditë, nuk na tregonte, vazhdon ai, por thoshte se kam pas punë me rëndësi”. “Në nëntor të vitit 1943, ishim me bagëti në Log të Lterit, rreth mesditës, Martini na tha që të kujdeshim për bagëtitë deri sa të vinte i vëllai, Lazri”. Ai na tha hapur se “po shkoj në luftë për çlirim dhe mirupafshim në Shqipërinë e lirë”. “Pas një 10 ditësh ka ardhur edhe një herë dhe ka ikur pas darke. Ishte 6 dhjetori, dita e Shënkollit të vjeshtës”, -tregon Zefi. Ai erdhi së bashku me Market Pjetrën dhe pasi na urojnë dhe filluan që të pinim nga një gotë raki, ai nuk priti por, çohet dhe merr një copë mish fërliku të pjekur një natë më parë. Veproji kështu se e ndjente veten si në shtëpi të vet, dhe ashtu ishte në të vërtetë, vazhdon Zefi. Martini kishte një pushkë shumë të bukur italiane, që më pëlqente shumë. Këtë pushkë ja kishin dhënë ata që i kishte përcjellë një vite më parë. Nga ky moment nuk e kam parë deri sa është çliruar vendi dhe ai është kthyer në Dukagjin me punë. Edhe vëllai i Martinit, Lazer Gjon Gila ishte në rreshtat e ushtrisë partizane që në formimin e batalionit Krujë – Ishëm, i cili u inkuadrua në Brigadën e 23 sulmuese, deri në çlirim e plotë të vendit.

Martin Gjoni qe nga ata luftëtarë e punëtor që, me qetësinë dhe heshtjen e tij, kërkonte që të mos dukej, të mos lavdërohej, e të qëndronte gjithnjë i thjeshtë, por që punonte shumë me të gjitha moshat, me të gjitha shtresat.

U rreshtua në batalionin partizan “Perlat Rexhepi” dhe, me riorganizimin e brigadave partizane rreshtohet në Brigadën e parë Sulmuese, shkoj edhe në tokat e Jugosllavisë dhe qëndroi atje deri sa gjatë kryerjes së një

detyre me rëndësi, duke kaluar përmes Alpeve Shqiptare, Guci-Bogë, në kohë me borë dhe të ftohtë të egër të nëntorit 1944 merr plagë nga të ftohtit, gati sa i kushtoj jetën, por bie edhe në përpjekje me forcat kundërshtare të luftës partizane në të hyrë të luginës së Shkrelit, megjithëse plagoset arrin që të largohet dhe takohet me Uc Selim Hasaj, i cili e merr pa mëdyshje dhe e strehon në shtëpinë e ti në Repisht për dy muaj, deri sa u shëndosh plotësisht. Nga fundi i dhjetorit të vitit 1944 u ribashkohet forcave partizane. Nga shtëpia, në të cilën u strehua Martin Gjoni, ishin dy vëllezër partizan me armë në dorë, Salo dhe Ibrahim Caf Hasaj. Ai arriti deri komisar kompanie, merr gradën toger dhe më vonë kapiten.

Pas çlirimit Martin Gjoni caktohet në batalionin që merrej me spastrimit nga mbeturinat e reaksionit, fillimisht në zonën juglindore dhe pastaj në zonën verilindore të vendit, detyrë që e kreu me guxim e vendosmëri, mjaft mirë. Për veprimtarinë e ti gjatë luftës nacionalçlirimtare disa herë është tentuar, nga reaksioni, që tu digjet shtëpia e Gjon Ndocit, por edhe Lulash Markut, Market Pjetrës dhe Mushak Dedës si pjesëmarrës dhe veprimtar në Luftën Nacionalçlirimtare.

Në ushtri punoi deri në vitin 1952, dhe pas disa kërkesave të përsëritura të bërë nga Martini, lirohet nga ushtria dhe caktohet sekretar i Komitetit ekzekutiv e rrethit të Dukagjinit, detyrë në të cilën qëndroi deri në suprimimin e rrethit sipas riorganizimit të bërë në atë kohë.

Me riorganizimin e organeve të qeverisjes vendore dhe shkurtimin e organikave, Martini emërohet drejtor i PTT në Breglumi, detyrë në të cilën punoj për disa vjet. Në këtë kohë u telefonizuan shumë fshatra të thella të Dukagjinit si dhe me rrethin Tropojë. Me krijimin e kooperativës bujqësore në Nica Shalë, Martin Gjoni u zgjodh kryetar i parë i saj. Me gjithë vështirësitë e kohës me vullnet dhe këmbëngulje të Martinit, me bashkëpunim me popullin, me mirëkuptim në zgjidhjen e problemeve te organizimit të jetës në këtë formë të re dhe të vështirë, pati rezultate.

Ishte shumë i interesuar Martini që të bëhej e mundur zbritja e shumë familjeve që kishin vështirësi ekonomike, dhe që kishin kërkuar që të zhvendose-

vijon në faqen 11

PREZANTIM DINJITIZ I KULTURËS SHQIPTARE NGA SHOQATA "ILIRIA"

- Në festivalin e 19-të, ritmet dhe vallet e Botes në Giavera del Montella-TV -

Nga **Beqir M. Cikaçi**

Javën që lamë pas u mbajt Festivali i 19° tradicional: "RITMET DHE VALLET E BOTËS", në Giavera del Montella provincë e Trevisos së Italisë. Për tri ditë reshtë, me date 6, 7 e 8 qershor 2014 u prezantuan shumë kultura, tradita, këngë, valle, koreografi, e te tjera të ndryshme nga të gjitha kontinentet e botës: Amerika, Afrika, Azia, Australia dhe Evropa.

Kulturën, traditën, veshjen, vallet dhe këngën shqiptare me dinjitet të lartë, si asnjëherë më parë, e prezantoi Shoqata ILIRIA e Trevisos. Kjo Shoqatë që përbehet nga shqiptarët që kanë origjinë nga Shqipëria, Kosova dhe Ilirida e Maqedonisë, ka vite që i prezanton shqiptarët në këtë Festival Tradicional, por këtë vit kishte bërë përgatitje më serioze. E veçanta e këtyre përgatitjeve ishte ftesa enkas për këtë festival e këngëtares vlonjate Ludmilla Baballeku, e cila me zërin e sajë i mahniti organizatorët dhe gjithë pjesëmarrësit. Ludmilla Baballeku kishte përkrah edhe këngëtarët e njohur Gjelo Hajdari, Gjin Shani, vogëlushen Kristina Hajdari dhe grupin e valleve me

veshje tradicionale të përgatitur nga Imer Kurti e Muhamet Murtezani.

Organizatorët duke i përcjell përgatitjet e Shoqatës, duke i njohur edhe cilësitë e mëparshme, Shoqatës ILIRIA dhe prezantimin e kulturës shqiptare i kishin rezervuar një minutash më të gjatë se zakonisht. Dhe nuk u zhgënjyen, sepse shqiptarët vërtetë u prezantuan dendësisht.

Në hapësirën e këndit (tendën) të Shoqatës ILIRIA, për të cilën u kujdes presidentja e Shoqatës ILIRIA, zonjusha Ermira Zhuri, ku kishte siguruar shumë gjëra tradicionale, si: qilima, veshje, rekuizita nacionale, flamuri Nacional Shqiptar, Flamuri shtetëror i Kosovës, ai i Shoqatës ILIRIA, e të tjera. Gjithashtu tavolina me libra, harta, atlase për tokat shqiptare, që për të interesuarit jepte sqarime ciceroni, Hamit Kurti. Gjithashtu për të interesuarit, pa pare, sigurohej edhe kafja shqiptare.

Paraqitja e grupit artistik e Shoqatës ILIRIA, filloi të shtunën në orët e pasdites me sfiliten nëpër qytet së bashku me gjithë pjesëmarrësit tjerë. Ndërsa e dielën pati tri paraqitje të shkëlqyeshme të ndara, në 30, 10 e 20 minuta. Këngëtarja

Ludmilla Baballëku me këngën "Shqipëri o nëna ime" i mahniti të gjithë me zërin e sajë, ndërsa shqiptarëve të pranishëm iu solli emocione e vërteta ku e shoqëronin dhe duke nxjerr lot mallëngjimi. Këngëtarja i njohur Gjelo Hajdari me këngën "Mërgimtari" i mbante në emocione shqiptarët, ndërsa të tjerët kureshtar të vazhdueshëm. Gjin Shani me këngën "Vallet tona" i shoqëruar dhe nga grupi i valleve, i bëri që shumë të pranishëm të hidhen në valle. E veçanta tjetër ishte edhe paraqitja e vogëlushes Kristina Hajdari me këngën: "Zemra rrahë për një Shqipëri" me globin në dorë, pati një paraqitje spektakolare.

Edhe pran tavolinës së këndit të Shoqatës herë pas here këndonte këngëtarja vlonjate, grupi vallëzonte duke krijuar spektakle të vërteta, ku interesimi ishte i veçantë, në valle hidheshin edhe të tjerë.

Festivali përfundoi në orët e vona të mbrëmjes, më 8 qershor 2014. Prezantimi i shqiptarëve u vlerësua shumë dinjitoz. Kështu shprehen organizatorët, por ishte edhe mendim i vete drejtuesve të Shoqatës ILIRIA. Merita kanë të gjithë pjesëmarrësit, këngëtarët, valltaret, shq-

iptaret e pranishëm, por gjithsesi duhet cekur: presidenten e Shoqatës ILIRIA, znjsh. Ermira Zhuri, Muhamet e Mumin Murtezani, Imer e Hamit Kurti, Gjin Shani, Gjelo Hajdari, e të tjerë.

Në përfundim të këtij reportazhi, morëm edhe një prononcim të Presidentes së Shoqatës "ILIRIA": "... I falënderoj të gjithë anëtarët e shoqatës, sidomos anëtarët e grupit artistik që me prezantimin dinjitoz na zbardhën fytyrën, dhe na krijuan mundësi që në të ardhmen të kemi një paraqitje edhe ma të madhe, Falënderoj gjithashtu edhe organizatorët për hapësirën e kohës që na siguruan, dhe sikur e kuptuam nuk janë zhgënjyer. Gjithashtu i falënderoj edhe gjithë shqiptarët që na përcollën gjatë ditëve të festivalit, por edhe ata që nga përgëzuan me komente përmes faqes së "facebookut", dhe pëlqimeve që i bënë aktivitetit të shoqatës tonë. Do të i'u jem mirënjohës edhe atyre që na bënë sugjerime e udhëzime. Ne, nuk do të ndalemi, do të vazhdojmë dhe në të ardhmen ...!", u shprehë ndër të tjera znjsh. Ermira Zhuri.





ME 15 QERSHOR 1389 U ZHVILLUA BETAJA E FUSHE-KOSOVËS!

- Kujtese historike për gjithë shqiptaret -



bërisë: Gjon Kastrioti, Gjergj Balsha, Arani dhe Muzaka.

Ajo, që vlen të theksohet dhe që asht objekt i këtij shkrimi modest, asht fakti se, në kte beteje të humbur, shkëlqen me të gjith madhësinë vepra heroike e djaloshit trim të Drenicës Legjendare, Millosh Obiliçi, i cili me një guxim të hekurt hyn në shtatoren e Sulltan Muratit dhe e there, duke e lanë të vdekur. Kaq shumë zemërohen pushtuesit osmane sa që nuk e varrosin kufomën pa marre hak dhe kte arrijnë duke vrare komandantin e koalicionit, Princ Llazarin dhe për të poshtnua arkivolin e tij e vendosin te kambet e Sulltan Muratit. Ndonëse kjo beteje u humb, ajo që të çuditë asht se, Heroit t'one, Millosh Obiliçi, nuk i kane ba ndonjë bust apo "shtatore", ndersa pushtuesin mizor, Sulltan Muratin e kane "Shenjtërua" duke i ngrite një Tyrbe, ku shkojnë e falen?!

Të njëjtin shenjtërimi kane ba serbet Prijës Llazarit, duke i ngrite një Kishe madhështore në Deçan, ku shkojnë dhe luten çdo vit. Asht, sa e çuditshme aq edhe e turpshme, kur ndonji "kolon" shqipfolës e quan Sulltan Muratin "çlirimtare"! Dhe pyetja shtrohet nga kush na çliruan osmanet??? Kush ka të paktën një minimum njohje të historisë e din shumë mire se, sllavet kane zbritë nga Urali që në shekullin e VI, pa lufte, por të varfër dhe të uritur. Pra, kur erdhën "çlirimtarët" osman, serbet kishin mbi shtate shekuj që banonin në ato hapësira. Vlen të theksojmë, dhe ky asht qëllimi i shkrimit se, humbja e betejës së Fushe-Kosovës asht disfata ma e madhe, dhe shkaku i prishjes së ekuilibrit mes shteteve te Ballkanit. Fajtoret dhe shkaqet duhet t'i tregojë historia dhe jo politikanet pa moral apo historianet konformiste, që bahen "pre" e Politikës. "Konformizmi asht më i rrezikshëm se atomi ...", thekson Ajnshtajni.

Të gjith shtetet e pushtuara nga Perandoria Osmane, u bane vasale dhe kush më shumë e kush më pak i shërbyen kësaj Perandorie, madje bane edhe krushqi me Sulltanin. Dihet Mehmet Ali Pasha ishte me origjine hungareze, i mbijqytun Maxhar Pasha. Vlen të theksohet se, ky

Pashe Turk u vra në shtator të vitit 1878 në Gjakovë, në shpinë e Abdulla Pashe Drenit. Kte akt, thellësisht patriotik e "vulosi" djaloshi trimi Krasniqes së Tropojë, Col Delija, dhe Populli e ka përjetua në kange. Ja disa vargje: "Col Delija sy sahati / Lumti goja mire vikati / Vete pa mbese /



Pashen po e çarti ..."

Aksionet kundër pushtuesve osmane janë të panumërta: Mic Sokoli i Krasniqes mbete Legjende; ndërsa fame madhe e Kelmendit, Nora, që ajo duhet të kishte monumentin në mes të Tiranës, por çuditërisht monumentet ju kemi ngritur pashallarëve dhe kolaboracionistëve ...?!

Ka monument Ali Pashe Tepelena, i cilësua nga historianet si me i madhi kriminel e shekujve XVIII-XIX (kujtoni masakrat mbi nenat suljote, që hidheshin nga shkëmbeje bashke me foshnjat e

tyre). Ne, si asnjë Popull tjetër i Ballkanit i "dhuruam" Turqisë 28 kryeministra. Vetëm ne patëm Aristokraci. Po kush posedon pronat e bujareve arbër, të cilët emigruan në Itali. Askush deri më sot nuk na ka shpjegua, ku janë pronat mbi 200 000 arbëreshëve që u larguan gjate kohës së pushtimit osman. Valle a mund të mburremi me pashallarë si, Esat Pashe Toptani, që i dorëzojë çelësat e ROZAFES-Krajl Nikolles!? A mund të mburremi, me tre kryeministra, që i shërbyen pushtuesit fashist dhe naziste?! A nuk ishte Shefqet bej Verlaci, ai që "përdhosi" Përkrenaren e Gjergj Kastriotit duke vene mbi kokën e Kryefashistit Italian-Viktor Emanuelit të III?!

As kush të mos mendoje se, nuk e dine Evropa kto fakte. Ne duhet të frymëzohemi nga verat madhore të Kastriotit, i vetmi burrë shteti para të cilit edhe shtetet më të fuqishme të Evropës duhet të përkulen. Nga heroit e nalpermendun dhe shume të tjerë duhet të frymëzohen politikanet t'ane. Në Evrope nuk mund të integrohemi me parulla e slogane, por vetëm me vepra.

Përgatitur nga **Mark BREGU**

SHËNGJINI DY GËZIME NË NJË DITË

Në çdo vit Shëngjini ka surpriza në çeljen sezoneve turistik, kjo për faktin se ka arritje të rezultateve. Qellim i vetëm i administratës së Komunës është përmirësimi i kushteve për pushuesit vendas e të huaj. Çelja e sezonit turistik për vitin 2014 u bë me datën 14 qershor. Në të njëjtën ditë u përrua edhe shtatorja At' Zef Pllumit. Prandaj edhe titullin këtij shkrimi ja vendosem "Dy gëzime në një ditë". Nuk thonë kot se, në ditë të bukura, ndodhin edhe gjëra të bukura. Pushuesit ishin të shumë, uji i ngrohet dhe natyra e qeshur. Për hapjen këtij sezoni morën pjesë me qindra qytetar nga Lezha, Shëngjini, por edhe nga gjithë Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e përtej Adriatikut. Në mes të ranishmeve ishin deputet, qeveritar, profesor, gazetar, artist e dhjetëra intelektual e të tjerë. Morën pjesë ish-presidentet i Kroacisë, Stipe Mesic, ish-presidentet e Shqipërisë Alfred Moisiu e Bamir Topi si dhe përfaqësues të klerit katolik, Monsinior Vitalo Ottava e të tjerë.

Tubimin e hapi Kryetari i Komunës Shëngjinit, Salvador Kaçaj, i cili falënderojë pjesëmarrësit për nderin e madh që i bëhet këtij qyteti, ardhja e qindra vetëve e në mes të cilëve figura të shquara.

Pastaj u përqendrua te arritjet e mëdha, që janë bërë këto dy vitet e fundit në të gjitha aspektet. Kryesisht në infrastrukturë, si shëtitoret, rruga e Kunes, e cila është drejtë përfundimit të kanalizimit të ujërave të zeza, furnizimi me energji elektrike e ujë të pijshëm pa ndërprerje, dyfishimi i hapësirave të gjelbëruara e mbi të gjitha sigurimi i qetësisë e rendit, shtimi i personelit shëndetësor duke e bërë 24 orësh e të tjera. Krahas këtyre theksoj, Kaçaj një punë të lavdërueshme kanë bërë edhe subjektet private. Në përgatitjen për të pritë pushuesit, si në hoteleri ashtu edhe në bar-restorante. Në Komunën e Shëngjinit funksionojnë rreth 50 Hotele, Bar-Restorante me rreth 4000 shtetë. Pa përmendur edhe qindra shtetë që lëshojnë me qira familjet e Shëngjinit. Përgatitjet kanë qenë vërtetë serioze duke u afruar madje nga një here edhe kaluar jo vetëm qyteteve bregdetare të Shqipërisë, por edhe fqinjëve tanë. Kryesorja është se, ushqimet që konsumohen janë bio të prodhuara nga fshataret e kësaj Komune. Prioritet është dhenë plazheve publike duke i trefishuar ato, të viteve të më pare. Vetë pozicioni gjeografik i Shëngjinit u jep mundësinë pushuesve të ndihen e të vizitojnë, vende

historike, zona të mbrojtura natyrore e të tjerë. Siç janë: Peizazhi natyror i rërës hedhur, knalla, rëra e vogël, skaliera në perëndim të rërës hedhur, maja e zezë, laguna kune-vain, gjiri i Drinit. Por edhe objekte historike e fetare: si Memorialin e Gjergj Kastriotit, Obeliskun, Kështjellën e Lezhës, kishën e Shënkollit e Shënpjetrit në mal të Rencit, kishën e Shëngjinit e të tjera. Qëllimi i vetëm është që Shëngjinin ta bëjmë një Amazon të vogël të Adriatikut. Kjo Komunë ka vlerësuar figurat e shquara të Shqipërisë, por edhe të shqiptarëve që jetojnë në hapësirat e tyre e në diasporë. Por, edhe sot tha kryetari i Komunës, ne përurojmë shtatoren e një birit të Shëngjinit, e jo vetëm tonin, por të gjithë Shqiptarëve. Penën e art, trimin dhe të pa mposhturin, filozofin dhe eruditin e pa shembullit, At' Zef Pllumit.

Pastaj e morën fjalën ish-presidentet Stipe Mesic, Alfred Moisiu, Bamir Topi si dhe monsinjor Vittale Otave, të cilët folën për arritjet e Shëngjinit këto dy vite si dhe u ndalën te figura e ndritur At' Zef Pllumit, i cili thane ai, dhe fama e tij i kanë kaluar jo vetëm kufijtë e Shqipërisë, Ballkanit por edhe të Evropës. Vuajtjet e tij në biruca, qelit, apo burgjet famëkeqe të diktaturës në Spaç, Burrel e të tjera. Qëndrojnë i pa përkulur duke duruar torturat më çnjerëzore, duke mbajtur mendjen tek Zoti e Atdheu i tij.

Në mes të tjerëve e mori fjalën edhe aktorja Roza Anagnosti, e cila në mes të tjerash lartësojë ketë figurë, figurën e një malësori, për të cilin duhet të krenohemi të gjithë Shqiptarët. Recitojë disa vargje të veprës së At' Gjergj Fishtës "Lahuta e Malsisë", ish profesor i At' Zef Pllumit, të cilat u pritën me duartrokitje të zjarra nga qindra të pranishëm.

Shtatoren At' Zef Pllumit e zbuluan ish-presidentet Stipe Mesic, Alfred Moisiu, Bamir Topi dhe Salvador Kaçaj. Pastaj Komuna e Shëngjinit nderojë me titullin "Mirënjohja e qytetit të Shëngjinit", z. Ketit Kaceli me motivacionin "Për përkthimin në gjuhën italiane të veprës të At' Zef Pllumit, Rrno për me tregue", e cila është botuar në miliona kopje. Gjithashtu dhe z. Ismail Demush dhe Çun Mula. Të dy të pranishëm, falënderuan Komunën e Shëngjinit dhe kryetarin e saj për nderin e madh që u beri atyre me dhënien e këtij titulli.

Në fund u dha një koncert artistik nga Ansambli i këngëve e valleve. Për të pranishmit u organizua një koktej, ne te cilin nuk munguan urimet e përzemërta. U shpërnda nga Komuna një album me fotografi e të dhëna për Shëngjinin, të titulluar "Amazona e Vogël e Adriatikut".

Përgatitur nga **Ndue ZIÇI**

Novela e veçantë

Autori, mjeshtri i madh, Fadil Kraja e ka quajtur novelë librin e tij me titull “Ylli i Bexhistenit”. Nëse është novelë apo diçka tjetër, për mua nuk ka shumë rëndësi. Për mua ka rëndësi se ky libër, është i veçantë, nëse është novelë, është novelë e veçantë. E mendoj të veçantë për faktin se e ka shkruar një njeri i veçantë, për një personazh të veçantë, i vërtetë dhe jo i imagjinuar, për Yllin e Bexhistenit.

Është fatkeqësi e madhe e shoqërisë tonë që nuk i njeh dhe as nuk i vlerëson njerëzit e veçantë. Të paktën kurrë aq sa duhet. Natyra, në momente të veçanta të stadeve të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, i ka dhuruar asaj gjenitë, njerëzit e mëdhenj, në të gjitha fushat, ata të cilët psikologjia i përmendin njerëzit e veçantë. Çdo popull e ka pasur dhe e ka një fat të tillë por, jo të gjithë i vlerësojnë, nderojnë dhe respektojnë njerëzit e veçantë, mendimtarët dhe gjenitë e tyre.

Kam shumë dëshirë të flas për Fadil Krajën si njeri i veçantë, por e kam shumë të vështirë të flas pasi nuk e ndjej veten të aftë nëse mund tua bëj të ditur të tjerëve të veçantat e tij. Të flasësh për Fadil Krajën, duhet të jesh po aq i madh dhe po aq i ditur sa vetë ai. Duhet të jesh i veçantë. Megjithatë, besoj se nuk gaboj nëse them se, njëra ndër veçoritë e Fadil Krajës është, kërkimi i njeriut pozitiv. Personazhet e tij janë arteriet e paqes dhe mirësisë njerëzore. I tillë është edhe Ylli i Bexhistenit, personazhi kryesor dhe i vërtetë i novelës.

Njeriu ndjenë dy lloje dhimbjesh-dhimbjen e vetvetes dhe dhimbjen e të tjerëve. Ata që ndjejnë vetëm dhimbjen e vetvetes, kthehen në hiq, shuhen sikur nuk kanë ekzistuar kurrë ose kthehen në përbindësia. Ata që ndjejnë dhimbjen e të tjerëve, që bashkëvuajnë me të tjerët ose ndryshe, siç mendohen në psikologji njerëzit empatikë, kthehen në legjenda. Krishti i kryqëzua se vuante nga dhimbja e të tjerëve, Migjeni u sëmure dhe vdiq në moshën rinore nga dhimbja që i shkaktoi

mjerimi i të tjerëve. I tillë ishte edhe Ylli i Bexhistenit. Mjerimi i grabitësve të tij nga familja malësore, e ulë në gjunjë atë dhe i shkakton dhimbje, dhimbje që kthehet në fatlumësi për ata mjeranë të “natës së zezë” shkodrane, siç e thotë autori.

Kurë njeriu përjeton padrejtësi nga të tjerët, gjithmonë përjeton dilemën midis faljes dhe hakmarrjes, midis humbjes dhe fitores. Falja është fitore, hakmarrja është humbje. Edhe falja është hakmarrje, është mënyra më moderne dhe më e suksesshme e hakmarrjes. Ylli zgjedh mënyrën më moderne të hakmarrjes,



faljen. Ai e falë hajdutin, madje i ndërton edhe shtëpinë. Njerëzorja e tij me hajdutin duket sikur nuk ka fund. Ai e merr edhe në punë.

Sipas traditës tonë primitive dhe kafshërore, i vetmi mjet që e lanë njollën e gjakut është gjaku. Dhe asgjë tjetër. Për Yllin nuk është ashtu. Ai zgjedh një mjet tjetër për të larë gjakun e derdhur në kantierin e tij. Zgjedh faljen dhe pajtimin

dhe ja arrin me shumë sukses. Ai, me një rëndësi, e shkulë thikën e pabesisë nga trupi i tij dhe dorën tjetër ja shtrinë agresorit për pajtim. Ylli është trim dhe i guximshëm. Trimi falë, frikacaku vret.

Jemi mësuar t’i mendojmë patriotë dhe t’u thurim këngë atyre që gjithnjë e kanë mbajtur gishtin në këmbëzën e pushkës dhe jo atyre që e kanë vënë në tëmthin e kokës, atyre të dhunës dhe jo atyre të mendjes. Të urtët dhe mendimtarët i ka mbuluar harresa. Ylli nuk e shprehë patriotizmin me pushkë por me mend. Ai jo vetëm e donë, por e dashuron Shkodrën, dhe ajo dashuri e shtynë atë që të mendohet thellë dhe të shkojë deri tek e pamundura për ta hijeshuar, pasuruar, zbukuruar dhe modernizuar

Fizikani heshtë. Të diturit duhet të kenë muskuj që ta marrin fjalën. Një mënyrë e të ushtruarit të dhunës mbi tjetrin është detyrimi i tij për te të dëgjuar vazhdimisht, mosdhënia e fjalës ose marrja e fjalës nga goja. Kjo është dhuna e bardhë, ajo psikike. Është shumë e dëmshme dhe me shumë pasoja. Disa vënë “shiritin magnetik” dhe të tregojnë për të dhjetën apo të qindtën herë po të njëjtat gjëra. Është e padurueshme. Ne vetëm flasim, në tavolinë, në familje, në punë dhe kudo. Flasim të gjithë dhe askush nuk dëgjon. Ne nuk diskutojmë dhe aq më pak, të shkëmbejmë mendime. Kjo është varfëri ndjenjash, mendimesh dhe idesh. Ylli është modeli i njeriut të aftë komunikues me të tjerët. Ai nuk flet, diskuton me deputetin dhe të tjerët. Ai e din shumë mirë se, çfarë duhet të thotë, kurë duhet ta thotë dhe ku duhet ta thotë fjalën e vet. Ai ndjenë shumë, guxon të mendojë ato që ndjenë dhe të shprehë ato që mendon, atëherë kurë duhet dhe aty ku duhet.

Në marrëdhëniet me njerëzit, gjëja më e suksesshme për njeriun është gjetja e vendit të vet. Kjo do t’i mënjante konfliktet midis njerëzve. Por, me sa duket qenka shumë e vështirë. Aty ku njerëzit ulen në vendin e huaj apo i hipin kalit të huaj, konfliktet shtohen dhe dhuna nuk ndalet. Ylli edhe në “natën e zezë” të Shkodrës, kurrë nuk e ngatërronte vendin e vet. As në punë, as në shoqëri, as me Erën e tij të dashur, as me ljen e as me fëmijët e tij.

Ata që do ta lexojnë këtë novelë, fare thjeshtë do ta kuptojnë se Ylli ka qenë dhe do të mbetet një arterie e paqes dhe mirësisë njerëzore.

Disa i fshinë vdekja, pa keqardhje dhe dhimbje dhe mirë bën që i fshinë. Disa të tjerë, i lartëson dhe i bën të paharrueshëm, ashtu si Yllin tonë, Yllin e Shkodrës. Gjithmonë do të dalë dikush, një Fadil Krajë, që do t’i rikthejë në pikën e ndërprerjes. Fadil Kraja, të faleminderit që na e riktheve Yllin midis nesh! Ylli, mirë se erdhe midis nesh!

Lekë Imeraj, Shkrimtar dhe përkthyes

Kush është-Shoqata ILIRIA, Treviso Itali?

Është një shoqatë vullnetare e formuar me 2005 , fillimisht me seli në Santa Lucia (TV). Vazhdimisht ka organizuar shqiptaret për festa kombëtare.

Gjatë një viti shkollor 2006-2007 ka zhvilluar edhe aktivitetin e Shkollës shqipe, por për mungesë mjeteve është ndërpre. Ka marr pjesë edhe në organizimet e vendorëve, duke prezantuar kulturën shqiptare te të gjitha hapësirave shqiptare.

Nga marsi i vitit 2012 selia e Shoqatës është vendosur në Treviso, ku edhe janë zgjedhur drejtues të ri, me presidente Ermira Zhuri dhe emigrant shqiptar nga Kosova e Ilirida nga Maqedonia Perëndimore.

Drejtuesit e ri kanë pasur një aktivitet më të ngjeshur. Është organizuar dendësisht 100 vjetori i Shtetit Shqiptar me 23 nëntor 2012, në të cilin na nderoi me

pjesëmarrje ambasadorja kosovare, Bukurie Gjonbalaj.

Në prill, 13 prill ka organizuar me sukses TAKIMIMIN ME DIASPOREN NE ITALI, të iniciuar nga Qeveria e Kosovës, që ishin prezent zyrtar nga Prishtina dhe Ambasada e Kosovës në Romë.

Këtë vit Shoqata jon ishte organizatorja e artisteve më të njohura nacional, qe u formua edhe dega e Fondacioni “Nermin Vlora Falaschi” për Itali, për të cilën presidente zgjodhën kryetaren e shoqatës tonë, zonjushën Ermira Zhuri.

Shoqata ka grupin artistik të valleve, dramatik dhe recituesve. Planifikojmë të riaktivizojmë shkollën shqipe të Mësimi Plotësues, pasi kemi intelektual të mjaftueshëm. Mungesa e mjeteve financiare e kushtëzon shumë në zhvillimin e aktiviteteve tjera.



Ermira Zhuri,
Presidentja e
Shoqatës “ILIRIA”

RADIO "JEHONA" ZËRI DHE JEHONA E KULTURËS BSHKËKOHORE SHKODRANE

E konceptuar artistikisht dhe e ndërtuar me parametrat bashkëkohorë të transmetimit, stacionuar në një nga kodrat që mbizotëron qytetin, zëri i kësaj radioje hyn në familjet shkodrane përmes emetit të valëve të saj, siç hynte jehona në përrallat e bukura shqiptare.

Në mekanizmin e madh e të pagabueshëm që rregullon jetën kulturore, artistike e shoqërore të Metropolit të Veriut, Radio "Jehona" është padyshim një ndër ingranazhet më të rëndësishëm.

Radio "Jehona" është radioja më e re që hyri në tregun mediatik me një pikësynim të qartë në formë dhe në përmbajtje, duke u bërë kështu një ndër Radiot më prestigjioze të zonës së veriut. Është themeluar nga një bord intelektualësh në vitin 2008. Ajo ka bërë një punë tepër fisnike nën drejtimin e themeluesit, drejtorit të saj z. Arben Halluni, i cili e ka ideuar vetë këtë media me disa objektiva të cilat i ka arritur me sukses, pasi në gjashtë radio në Shkodër, radhitet e para. Në rang kombëtar ajo radhitet e katërta.

Radio "Jehona" është nga radiot më të pëlqyera dhe më të dashura për qytetarët e Shkodrës dhe më tej, pasi shtrirja gjeografike e saj me valën e transmetimit nuk është vetëm në Shkodër, por edhe më larg si: Në Malësi të Madhe, Pukë, Lezhë, Laç, Krujë, Fushë Krujë, Durrës, Tiranë (pjesërisht), por edhe në trojet shqiptare si në Tuz, Ulqin dhe Krajë, duke qenë e pranishme në çdo ambient familjar dhe shoqëror si dhe në çdo automjet të qytetit të Shkodrës dhe më tej.

Radio "Jehona" këto ditë festoi 5 vjetorin e debutimit të saj. Në këtë përvjetor që kjo Radio e re sapo mbushi e gjeti stafin e saj me një përkushtim edhe më të madh për të përgatitur diçka më të veçantë dhe më të suksesshme duke punuar në mënyrë intensive me profesionalizëm për t'u paraqitur sa më mirë përballë audiencës qytetare shkodrane, por edhe më tej, në mënyrë që të jetë një ndër mediat partnere të secilit prej dëgjuesve, duke sjellë më afër çdo ngjarje dhe informacion në interes të tyre.

Me programacionet e larmishme të saj, kjo radio ka fituar simpatinë e shumë dëgjuesve, në sajë të një stafi të aftë që bën përzgjedhjen e muzikës popullore, muzikës së lehtë, si dhe rrymave të tjera të muzikës. Pjesë e programacionit të kësaj Radioje janë edhe ato me karakter politik, ekonomik, social, dhe sportiv.

Pjesë e Radio "Jehonës" është edhe flesh informativ dhe edicioni i lajmeve që transmetohet orë pas ore, duke u përpjekur për të qenë sa më në korrent me dëgjuesit e saj, duke përcjell informacionin sa më shpejt dhe sa më të saktë, në mënyrë që secili prej qytetarëve që nuk ka mundur të marrë një informacion nëpërmjet mediave vizive, apo nëpërmjet mediave të tjera, të informohet nga kjo radio.

Radio "Jehona" është konfirmuar si radioja më e pëlqyer jo vetëm në Shkodër, por edhe më tej për faktin se në shtrir-

jen gjeografike që ka ajo, ka mbi 800 mijë dëgjues të cilët në këtë 5 vjetor e kanë falenderuar. Kanë dërguar sms duke krijuar kështu një suport dhe mbështetje, të cilat kanë bërë që ky staf jo vetëm të ndjehet i motivuar, por edhe të punojë më shumë në të ardhmen.



Kjo Radio është e para që ka një rekord dëgjuesish në automjete, një motiv tjetër ky që e bën këtë staf të punojë edhe më me përkushtim, duke u vënë para një përgjegjësie që ta ruajnë edhe më tepër cilësinë dhe profesionalizmin, pasi radhitet në vendin e katërt në shkallë kombëtare për dëgjueshmëri në automjete.

Një meritë të veçantë për këto arritje në këtë media padyshim ka edhe drejtori i kësaj Radioje z. Arben Halluni, i cili së bashku me stafin e tij, jo vetëm kanë pasur arritje në larminë e progamacionit, por edhe arritje të cilësisë profesionale.

Për këtë përvjetor kanë dhënë urime, falënderime dhe vlerësimet e tyre edhe organet e pushtetit lokal, por edhe nga fushat e politikës, kulturës, artit, sportit, nga komunitetet fetare, nga kolegët e tyre gazetarë, nga intelektualë të shquar

të qytetit të Shkodrës, si dhe nga fushat e tjera me të cilat kjo Radio bashkëpunon, operon apo është partnere.

Në rrugëtimin e saj 5 vjeçar, kjo Radio erdhi duke konsoliduar punën e vet, për të mos qenë thjeshtë një "altoparlant" që transmeton vetëm këngë, por edhe një

ka shtrirë edhe me Radio të tjera si: Radio "Maria", Radio "Kajro" në Egjipt, Radio "Besa" në Prizren, TRT në Turqi si dhe me televizionet lokale të Shkodrës dhe atë të Koplikut, duke dhënë kështu shembullin e një misionareje që bashkon gjithë botën shqiptare.

Falë teknologjisë bashkëkohore, kjo Radio transmeton 24 orë. E veçanta e këtij transmetimi është se prioritet kanë veçanërisht këngët popullore qytetare shkodrane, duke mbizotëruar kryesisht këngët e vjetra si perla të pakrahasueshme nga këngëtarë të famshëm. Puna e këtij stafi, bazohet më shumë tek vullnetarizmi dhe kontributi i qytetarëve shkodranë, të cilët janë të interesuar sidomos për mbarëvajtjen e emisioneve shpirtërore. Jo vetëm në Shkodër, por edhe përtej kufijve shtetërorë. Një shembull i tillë është edhe Nusret Tula nga Ulqini, i cili ka ndihmuar financiarisht me dëshirën e tij për këtë Radio.

Në projektet e kësaj Radioje është edhe hapja e një televizioni lokal me të njëjtin emër "Jehona". Në vitin 2013 është vlerësuar nga Instituti i Mediave Center si Radio më e dëgjueshme në Qarkun e Shkodrës. Përmes internetit kjo Radio transmeton online në adresën: www.radiojehona.al Fm 107.6Mhz, ku ka faqen e saj informative për problemet aktuale të ditës, e cila çdo ditë vjen e zgjerohet. Ajo përçon valët e saj në gjysmën e Shqipërisë, duke qenë një Radio e pëlqyer dhe e respektuar për përpikërinë dhe larminë e saj mediatike.

Ashtu siç ka edhe emërtimin, Radio "Jehona" punon çdo ditë për të perfeksionuar punën e saj, sepse ideatori dhe stafi janë të ndërgjegjshëm që kanë marrë përsipër një mision të bukur dhe të vështirë, por edhe të lavdërueshëm dhe edukativ. Në mikrofonin e kësaj Radioje, gjithmonë do të gjejë jehonë arti, kultura dhe mendimi intelektual.

Përgatitur nga **Ramazan ÇEKA**



poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi*** poezi *** poezi*** poezi *** poezi

Ku linda? Ku u rrita? Dhe ku po tretem?...



Gjin Musa

U linda atje ku alpet prekun qiellin
u linda në fshatin Nanmavriq
atje ku burrnia dhe pushka ulen kambkryqe,
atje ku trimat lindin ne ç'do voter.
U linda aty ku lindi Ndok Gjelooshi.....
aty në Nanmavriq holla hapin e pare
Aty thiirra për here të pare emrin Nane.

I vogël, ende tre vjeçar
prindërit e mije morën rrugën e “mërgimit”
kërkuan për mua një jete ma te mire,
U vendosen ne fshatin Kukel,
aty ku Mjeda kishe qene famullitar
aty u rrita, aty mësova shkrim dhe këndim
në shkollën fillore, me emrin “Ndre Mjeda”.

Aty, në atë fshatë përbri malit Kakarriq
u rrita me halle dhe me shume mundime
dy prind, që bene gjith ç'kahin të na rrisnin sa ma mire
aty, unë krijova jetën, ne dhomat muze të Mjedës
ç'do dite kaloja, lexoja ato poezi që ishin publikuar
Mjeda u ba frymëzim për mue
që të shkruaje ç'fare ndjeje, dhe çfarë shohë me sy
ta shprehe dashurin për vendin time.

Njerëzit xheloz dhe zemër keq, më sulmonin
isha i pa përfillshëm me të keqen,
se duroja pa drejtuesin, jua thosha ne sy
po gati ishte ndëshkimi ndaj meje ...
sa pa drejtësi mu bane!! i përballova
kurrë para të keqes nuk u dorëzoval.

Mora rrugën e mërgimit
në kërkim te një jete ma të mire
shkova nga nuk shkova,po jete t' pa telashe

askund nuk gjeta.
Gjeta atë, që me kishe munguar nder vite
fjalën e lire, jetën e sigurte, po vështirësi ka kudo.

Evropa e bukure, e kishim andërruar
ja ku jemi sot, ne zemër të Evropës
po me një ndryshim, që sa shume me habite
njeriu për njeriun është kthyer në ujk,
askush nuk do ja di, jete kapitali!!!.
Dhe krejt si pa dashur më vjen frymëzimi
të shkruaj këta rreshta këtu nga mërgimi.
Ku linda? ku u rrita? Dhe ku po tretem?
Kjo, o miqtë e mije është sot jeta.

Prap po vriten bijt pas shpine

- Kushtuar ELVIS PISTËS –

Ti Elvis i Rahovecit
Ti Elvis, djalë i Arbërisë
Ti sot dhëndër prapë u bëre
Ditë e zezë e Dardanisë

Pak më parë për disa muaj
Martoi nëna të vetmin djalë
Si do t'ndjehet sot zemra e nënës
Kur ja bien n'shtëpi të vranë

Ta zunë priten pas mesnate
Ti s' mendoje që ka krime
Kriminelët zbrazen armën
Në tradhti të vranë pas shpine

Kushdo qofshin e ngado qofshin
Krimineli ka veç një fytyrë
I ka duart zemërprishuri
Plot me gjak deri në bërryle

Deputet populli të zgjodhi
Ta dha votën e besimin
S'ka mendua Rahoveci
Sot me gjak ta zbardh agimin

Nusja jote e dashura nuse
Gjakun tënd në bark e mban
Rrobat tua në shtrat t' nusërisë
Krejt me lot e shkreta i lanë

Mallkon jetën edhe fatin
Mallkon vrasësin e kriminelin
Plagë në zemrat e nuseve tona
Plagë në zemrën e atdheut

Dardania qan me lot
Si e kemi kështu shtetin
N' liri vritet çlirimtari
N' liri vritet deputeti

Nga Agim Gashi, 15. 06. 2014, Düren

ATJE TE SHTËPIA E VJETËR

Poemë nga Luigj Temali

Rrezet e Diellit...
lëshonin pingul
si shtullunga zjarri
të furrave të çelikut
gjithë afshin e tyre
përvëlues.
Dikush....

Atje te shtëpia e vjetër
në mëhallë
hipur mbi një kal
pa frena e shalë
në mes të rrugës
Shkodër- Pukë
Afër ish
Ndërmarrjes Artistike
vraponte si në garë....!

Një makinë...
me drejtim:
Kush e di?
plot zhurmë, tym e bori
kaloj pranë tyre
me shpejtësi.

Sa çelë e mbyllë sytë
humbi ekuilibrin
u përmbys!
Ata ranë me shpinë
e këmbë përpjetë
pranë një gardhi
brenda në hendek!

Me kosë në dorë
duke ulëritur si hienë
në mes të shkretëtirës
erdhi tragjedia!
Patkonjtë e kalit
u bënë një
me telat



me gjemba
të gardhit!

O Perëndi!
Poshtë ti ndodhej ai!
Rrugës s'kishte njeri.
Koha
në momente ekstreme
është ...!
Margaritar, ar e flori!

Bashkëmoshatari im
më la pa mend
kapërceu gardhin
“fluturoi” si shpend.
Me guxim dhe shkathtësi
hoqi telat e ngatërruara
së pari nga patkonjtë
Te këmbët e mbrapse
e ka folenë rreziku!

Sapo u ndie i lirë
i dha vetës hop përpjetë
Turfulloj
U shkund fort
dhe u nisë drejt qytetit
ku ta çonte rruga vetë!

Pas atij gërmuq
Me sup e shpatull të thyer
doli nga “Ferri”
“rekordmeni” ynë çelik,
që shpëtoj mrekullisht!
nga një fund i tmerrshëm
tragjik.

Kam mall e nostalgji
Unë në një qoshe
këtu në Shqipëri
Kurse ai atje larg
në fund të Botës
në Australi!

Ky tregim i thurur
në vargje poetike
është i saktë
Me at djaln
dikur 17 vjeçar
sot plak
jemi si “vëllezër binjak”!

MARTIN GJONI “nuk i trembet varrit”

vijon nga faqe 5

shin, që vinte si pasojë e shtimit të popullsisë dhe tokës së paktë bujqësore. Ai e pati bërë problem deri te ish Kryeministri Mehmet Shehu dhe pati marrë premimin për të sistemuar rreth 500 familje në toka buzë liqenit të Shkodrës, nga Kiri- razi e deri në Buzë të Ujit të Malësisë së Madhe, por vetëm pak shtëpi pranuan që të zbrisnin, pavarësisht se më parë kishin kërkuar shumë. Për këtë me rekomandimin gojor të ish Kryeministrit Mehmet Shehu u kërkua që Martini të përjashtohet nga Partia, por organizata nuk e lejoi një gjë të tillë, e zbriti në kandidat partie, masë të cilën e kreu me vendosmëri dhe u kthye në normalitet. Pavarësisht kësaj mase Martini nuk u tërhoq, nuk u mbyll në vetvete apo brenda mureve të shtëpisë, por vazhdoi punën me masën e gjerë, me të rinjtë, me nxënësit e shkollave, me popullin për të ndikuar në përmirësimin e jetës së popullit të zonës

së Dukagjinit. Ishte këmbëngulës në kërkesën për hapjen e rrugës së makinës nga Thethi në Breglumit. Martin Gjoni ishte anëtar partie, por ishte vërtetë një komunist demokrat. Ishte i kudogjendur për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, pa dallime klasore.

Martin Gjoni është dekoruar me shumë dekorata e medalje për pjesëmarrje në Luftën Nacionalçlirimtare dhe veprimtarinë e tij në fusha të ndryshme shtetërore dhe shoqërore.

Në shtëpinë ku u lind Martin Gjoni, në Lotaj qëndron pllaka përkujtimore “Bazë e luftës Nacionalçlirimtare”. Ka qenë drejtues i komitetit të veteranëve të zonës së Dukagjinit dhe anëtar i kryesisë së veteranëve të rrethit Shkodër dhe ka bërë një punë mjaft të mirë për evidentimin e patriotëve dhe luftëtarëve të kësaj zone për liri dhe përparim shoqëror.

Ishte shumë i dashur dhe shumë i këndshëm në biseda me popullin, për

zgjidhjen e mos marrëveshjeve midis personave të ndryshëm, kishte shumë dëshirë dhe punoj për publikimin e vlerave të Dukagjinit dhe dukagjinave në të gjitha kohët. Një meritë të veçantë ka Martini për punën mjaft të madhe në grumbullimin dhe sistemimin e materialeve për botimin e librit “Dukagjini ndër shekuj”, i cili doli pas vdekjes së tij nën autorësinë e Ndue Cukelit.

Në një nga gazetatat e përditshme, me rastin e vdekjes së Martin Gjoni Gilës, midis të tjerash shkruhet “Dy jetë askush s'i ka, kjo dihet. Jeta mund të jetohej shumë mënyrësh. Por kryesorja është veprimtaria komplekse që kryen gjatë gjithë jetës. Në fund të fundit, edhe për çfarë do të kujtojmë më pas. Martin Gjoni, nga Dukagjini i thellë malor është ndër ata njerëz që kujtohet për të mirë. ... u nderua ashtu siç e meritonte. Martin Gjoni nuk u bë kështu i respektuar rasisht. Jo, ishte edukata e prindërve që

në vegjëli që mbodhi te ai virtytet më të mira njerëzore. ... Martini ishte ndër partizanët e parë të Dukagjinit, ishte ndër kuadrot e para për rindërtimin e vendit, ishte ndër aktivistët e parë të punëve të dobishme shoqërore. ...”. Djemtë dhe vajzat e Martinit kanë përse ta kujtojnë ... ndaj këta e mbajnë kokën lart për babën e tyre. ... për këtë, Martin Gjoni na jep një shembull se çdo prind duhet të mendojë që fëmijëve t'u lerë trashëgim jo vetëm pasuri, por dhe virtytet e një jete të thjeshtë dhe të ndershme.

“Nuk i trembet varrit” ky njeri, tha për Martinin një bashkëkohës i tij. Është mjaftë domethënëse kjo për njeriun e mirë”.

Përgatitë nga ADEM KURTULAJ, Anëtar i kryesisë së veteranëve të rrethit Shkodër dhe ZEF SOKOLI, fshati Lotaj



Peisazh alpin



REDAKSIA
 Kryeredaktor: Lazër Kodra
 Redaktorë: Lazër Stani, Roza
 Pjetri, Prelë Milani, Luigj
 Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika,
 Zef Gjeta, Lulash Brigja